



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI AVIACIONIT CIVIL

Adresa: "Sulejman Delvina" Nr. 1, Tiranë. Tel / Fax: +355 4 2223969, Email: info@acaa.gov.al

Nr. Prot 470

Datë 28/03 / 2016

Vendim

Nr 3 Datë 28/03 / 2016

**Për miratimin e procedurës së brendshme për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil
dhe përgatitjen e një baze të dhënash për këto raportime**

Rishikimi 1

Në zbatim të Nenit 13, pika a, dhe pika g, të Ligjit Nr. 10 233, datë 11.02.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar: Urdhrit të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr.68, datë 10.06.2011 "Për miratimin e Rregullores për Raportimin e Ngjarjeve në Aviacionin Civil" dhe Urdhrit të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 123 datë 22.12.2011 "Për Miratimin e Rregullores për Integrimin në një Bazë Qëndrore të Informacionit për Ngjarjet në Aviacionin Civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara".

Vendosa:

1. Miratimin e procedurës së brendshme "Për Raportimin e Ngjarjeve në Aviacionin Civil dhe përgatitjen e një baze të dhënash për këto raportime", Rishikimi 1.
2. Vendimi i Drejtorit Ekzekutiv Nr.6 date :18.03.2013 "Per raportimin e ngjerjeve ne aviacionin Civil dhe pergatitja e nje baze te dhenash per keto ngjarje" shfuqizohet.
3. Ngarkohen Drejtoritë e përcaktuara në procedure, për zbatimin e parashikimeve të saj.
4. Ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë të marrë masa për krijimin e një baze qendrore të dhënash për Autoritetin e Aviacionit Civil.
5. Ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemeve të Manxhimit të Sigurisë në Autoritetin e Aviacionit Civil, të bashkërendojë punën me Drejtoritë e tjera të Autoritetit të Aviacionit Civil si dhe me subjektet raportuese apo të interesuara për informacionin e raportuar, në funksion të zbatimit të kësaj procedure.
6. Ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë në Autoritetin e Aviacionit Civil të koordinojë me OKIIAn për sinkronizimin e ngjarjeve të raportuara.

7. Ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë në bashkëpunim me sektorin e Informacionit, të marrë masa për publikimin për raportimin e ngjarjeve në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Ky vendim hyn në fuqi 5 ditë pas datës së miratimit.

Aleksander LIPIVANI

DREJTOR EKZEKUTIV





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURES**



Autoriteti i Aviacionit Civil

**PROCEDURA E BRENDSHME PËR RAPORTIMIN E
NGJARJEVE NË AVIACIONIN CIVIL DHE PËRGATITJA E
NJË BAZE TË DHËNASH PËR KËTO RAPORTIME
RISHIKIMI 1**

SHKURT 2016

Ky dokument është pronë e:

Autoritetit të Aviacionit Civil Shqipëtar

Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1
Pranë Parkut të Delegacioneve
Tiranë / Shqipëri
Po Box 205

Ndalohet çdo riprodhim ose ndryshim i këtij materiali, pa pëlqim me shkrim.

Shpërndarja e paautorizuar e këtij dokumenti ose pjesëve të tij, jashtë shpërndarjes zyrtare, sipas përkufizimit të këtij dokumenti, do të cilësohet si shkelje e procedurave të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe do të trajtohet përkatësisht me punonjës të përgjegjës.

Ky individ mund t'i nënshtrohet procedimit ligjor nga institucionet përkatëse ligjore.






Për Publikuesin:

Drejtor Ekzekutiv



LISTA E NJEKJEN DHE MBYLLJEN E NGJARJES SË RAPORTUAR

Kapitulli	Faqe	Rishikimi	Datë
Hyrje	7	Versioni 0	18.03.2013
Objekti	7	Versioni 1	23.12.2015
Detyrat	8	Versioni 1	23.12.2015
Procesi	8	Versioni 1	23.12.2015
Forma për ndjekjen dhe mbylljen e ngjarjes së raportuar	21	Versioni 1	23.12.2015

	Emri dhe pozicioni	Datë	Nënshkrimi
Përgatitur nga:	Elton Kacagjeli, Përgj. Sektori i SMS	09.02.16	
	Edmira Çuko, Inspektor i SMS	09.02.16	
Kontrolluar nga:	Feliks Baci, Drejtor i DKCSMS	11.02.16	
Rishikuar nga:	Edlira Kraja, Drejtor i Standartizimit Teknik	11.02.16	
Miraturar nga:	Aleksander Lipivani, Drejtor Ekzekutiv		

LISTA E SUPLEMENTARJES

Përdoruesi	Media/Mediumi	Sasia
Arkivi	Shkresore	1
	Elektronike	1
Intranet	Elektronike	1
DAMO,DMSA,DMAA,DKCSMS,DMSHLA Staf	Elektronike	1

PROVA PER L'INSEGNAMENTO

Nr	Data	Risultato	Nr	Data	Risultato
1	23.12.2015	Edmira Çuko Elton Kacagjeli			
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					

PËRMBLEDHJE

Kjo procedurë e brendshme është përpiluar në përputhje dhe për zbatimin e Urdhrit të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr.68, datë 10.06.2011 “Për miratimin e Rregullores për Raportimin e Ngjarjeve në Aviacionin Civil” dhe Urdhrit të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit Nr. 123 datë 22.12.2011 “Për Miratimin e Rregullores për Integrimin në një Bazë Qëndrore të Informacionit për Ngjarjet në Aviacionin Civil dhe shpërndarjen e këtij informacioni te palët e interesuara”.

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	7
2. Objekti.....	7
3. Detyrat.....	8
4. Procesi.....	8
4.1 Procesi i menaxhimit të një ngjarjeje të raportuar.....	9
5. Aneksi A: Forma për ndjekjen dhe mbylljen e ngjarjes së raportuar.....	22

1. Hyrje

Kjo procedurë e brendshme përshkruan proceset e marrjes dhe shpërndarjes tek palët e interesuara për raportimin e ngjarjeve në aviacionin civil si dhe vendosjen e rregullave për t'u përdorur nga Autoriteti i Aviacionit Civil për grumbullimin e raportimeve të ngjarjeve dhe për mirëmbajtjen e sistemit të mbledhjes dhe analizimit të këtyre raporteve.

2. Objekti

Kjo procedurë e brendshme trajton dhe ka për qëllim përmirësimin e sigurisë ajrore në Aviacionin Civil me anë të sistemit të Raportimit të Ngjarjeve, ku synimi kryesor është parandalimi i aksidenteve dhe incidenteve ajrore.

Kjo procedurë përcakton hapat që duhet të ndërmerren nga Autoriteti i Aviacionit Civil për krijimin e një baze qendrore të dhënash për ngjarjet e aviacionit civil, nën juridiksionin e shtetit shqiptar dhe që trajtohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil. Gjithashtu në këtë procedurë përshkruhen veprimet që ndërmerren nga njësitë organizative në Autoritetin e Aviacionit Civil për trajtimin e një ngjarjeje të raportuar.

Disa parashikime të kësaj procedure janë edhe masat për integrimin në një bazë qendrore të informacionit mbi ngjarjet që ndikojnë në sigurinë ajrore dhe që shkëmbehen nga autoritetet kompetente të shteteve të ZPEA-së, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe.

Kjo procedurë e brendshme zbatohet nga të gjitha Drejtoritë e Autoritetit të Aviacionit Civil, të listuara si më poshtë së bashku me sektorin përkatës që do jetë përgjegjës për kordinimin dhe bashkëpunim me sektorin e SMS-së të ngarkuar për Raportimin e Ngjarjeve, pjesë e Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë:

- Drejtoria e Mbikqyrjes së Operatoreve Ajrorë dhe Organizatave të Miratuara të Mirëmbajtjes, me Sektorin e Vlefshmërisë Ajrore dhe Mirëmbajtjes si përgjegjës;

- Drejtoria e Mbikqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror, me Sektorin Teknik si përgjegjës;
- Drejtoria e Mbikqyrjes së Aeroporteve dhe Aerodromeve, me Sektorin e Parrezikshmërisë dhe Certifikimit si përgjegjës;
- Drejtoria e Mbikqyrjes së Sigurisë në Aviacion, me Sektorin e Certifikimit dhe Mbikqyrjes së Personelit të Sigurisë si përgjegjës;

3. Detyrat

Detyrat e personit/personave të cilët do të merren me krijimin, mirëmbajtjen, analizimin e këtij sistemi janë si më poshtë:

- Të krijojë bazën e të dhënave dhe të informacionit të ngjarjeve të raportuara;
- Të regjistrojë të gjitha ngjarjet e raportuara në sistemin e integruar ECCAIRS;
- Të mirëmbajë bazën e të dhënave dhe informacionit të ngjarjeve të raportuara;
- Të sigurojë që raportet e ngjarjeve t'u shpërndahen në masën e duhur personave kompetentë në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- Të shpërndajë Raportet e Ngjarjeve sipas kategorive si dhe shpërndarjen e këtyre informacioneve tek palët e interesuara;
- Të komunikojë në mënyrë të vazhdueshme me personat e emëruar nga drejtoritë përkatëse për trajtimin e Raportimeve të Ngjarjeve;
- Të kryejë koordinim të vlerësimit të riskut nga përfaqësuesit e emëruar nga drejtoritë përkatëse;
- Të krijojë një listë përmbledhëse të Raportimit të Ngjarjeve në Excel File;
- Të koordinojë me OKIIAn për sinkronizimin e ngjarjeve të raportuara;
- Të ruajë konfidencialitetin e raport-dhënësve;

4. Procesi

Personi përgjegjës për krijimin dhe mbajtjen e bazës së të dhënave të Raportimit të Ngjarjeve në DKCSMS në Autoritetin e Aviacionit Civil do të kryejë veprimet si më poshtë:

- do të mbledhë dhe regjistrojë raportimet e pranuar;

- do të klasifikojë raportimin, të përcaktojë kategorinë dhe drejtorinë së cilës i duhet dërguar më pas;
- do të raportojë për sa më sipër tek Drejtori Ekzekutiv;
- do të shpërndajë raportimin në organet apo drejtoritë përkatëse;
- do të koordinojë me drejtorinë ku është dërguar raporti për të përmbledhur të dhënat e këtyre raportimeve të ngjarjeve;
- do të analizojë riskun në bashkëpunim me personat përkatës të drejtorive që mbulojnë fushën ku ka ndodhur ngjarja;
- pas kategorizimit të ngjarjes për nga rëndësia, në rast të një ngjarjeje të rëndë, do të marrë masa për të ndarë të dhënat me Organin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve;
- në çdo rast do të koordinojë me OKIIAn për ngjarjet e raportuara;
- do të mirëmbajë e ruajë bazën e të dhënave mbasi procesi i Raportimit të një Ngjarje të jetë Mbyllur;
- do të mbajë kontakte me strukturat përkatëse të ECCAIRS, me qëllim realizimin e procesit të raportimit, në funksion të integritit të ngjarjeve në sistemin e integruar europian.

4.1 Procesi i menaxhimit të një ngjarjeje të raportuar

Baza Ligjore	Personi/sektori Përgjegjës	Përshkrimi i Procesit	Dokumentacioni përfundimtar
<p>Raportimi i Ngjarjes</p> <p>UM Nr. 68, datë 10.06.2011 "Për miratimin e rregullores mbi Raportimin e Ngjarjeve në Aviacionin Civil"</p> <p>Procedura e Brendshme "Për Raportimin e Ngjarjeve në Aviacionin Civil dhe Përgatitja e Një Baze të Dhënash për këto Raportime", Rishikimi 1</p> <p>Procedura e Jashtme e "Zbatimit të Rregullave për Raportimin e Detyrueshëm të Ngjarjeve në Aviacionin Civil", Rishikimi 1</p>	<p>Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë</p> <p>Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë</p> <p>Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë</p> <p>Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë</p> <p>Drejtori i Drejtorisë</p> <p>Drejtori i Drejtorisë</p> <p>Inspektori Investigues</p> <p>Inspektori Investigues</p> <p>Drejtori i Drejtorisë</p> <p>Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë</p>	<pre> graph TD Start([Nisja procesit]) --> Step1[Raportimi i Ngjarjeve] Step1 --> Dec1{A është raporti konfidencial?} Dec1 -- PO --> Step2[Raporto tek DD] Step2 --> Step3[DD Raporto tek DE ose Zv/DE] Step3 --> Step4[Ruajtja e konfidencialitetit] Dec1 -- JO --> Step5[Rregjistrimi në: - Formën (AAC-MOR_07) - Programin ECCAIRS - Listën përmbledhëse të Raportimit të Ngjarjeve në Excel File] Step4 --> Step5 Step5 --> Step6[Dërgimi i raportit në drejtorin përkatës] Step6 --> Dec2{Investigimi i ngjarjes?} Dec2 -- JO --> Step7[Raporton Mbylljen e ngjarjen] Dec2 -- JO --> Step8[Cakton Personin që do të investigojë ngjarjen] Step8 --> Step9[Investigo Ngjarjen] Step9 --> Step10[Raporti përfundimtar i investigimit & rekomandimet] Step10 --> Dec3{Vendimi për të raportuar mbylljen e ngjarjes?} Dec3 -- JO --> Step7 Dec3 -- PO --> Step11[Forma AAC-MOR_07 Regjistrimi i ngjarjeve në ECCAIRS Një përmbledhje e ngjarjeve në Excel] Step11 --> End([Fundit i procesit]) </pre>	<p>Rregjistrimi në: - Formën (AACMOR_07) - Programin ECCAIRS - Listën Përmbledhëse të Raportimit të Ngjarjeve në Excel File</p> <p>Rekomandime për veprimet korigjuese dhe parandaluese; Plotësimi i Formës AAC-MOR_07 me rekomandimet e Personit Investigues</p>

1. Raportimi i ngjarjeve bëhet me anë të: adresës së e-mail www@kcsms.al (në të cilën ka akses sektori i SMS-së pranë Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë), telefonit: + 355(0) 42 25 12 20, fax-it: +355 (0) 42 22 39 69 ose dërgohen me postë në adresën zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil.

2. Personi i ngarkuar për mbledhjen e ngjarjeve është Inspektor Teknik në sektorin e SMS-së pranë Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë. Në mungesë të Inspektorit Teknik në sektorin e SMS-së, personi tjetër përgjegjës për mbledhjen e ngjarjeve është Përgjegjësi i Sektorit të SMS-së në DKCSMS-së. Inspektori Teknike (IT) kontrollon nëse raporti është konfidencial apo jo. Nëse raporti është konfidencial, IT e dorëzon raportin tek Drejtori i drejtorisë i cili më pas e përcjell tek Drejtori Ekzekutiv ose në mungesë të tij tek Zv/Drejtori Ekzekutiv. Përgjegjësi i sektorit të SMS-së duhet të vihet në dijeni për raportimin përkatës dhe duhet të përfshihet në klasifikimin e ngjarjes, analizat përkatëse etj.

Në rastet kur nuk mund të kemi komunikim me Drejtorin Ekzekutiv, ngjarja e raportuar konsultohet me përgjegjësin e sektorit dhe Drejtorin e DKCSMS.

Drejtori Ekzekutiv, ruan konfidencialitetin e raportuesit duke fshirë ose fshehur emrin e raportuesit dhe e dorëzon raportin tek Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë. Vetëm Drejtori Ekzekutiv mund të kontaktojë raportuesin, nëse është e nevojshme.

3. Nëse raporti nuk është konfidencial, IT plotëson Formën (AAC-MOR_07)¹ me të dhënat e ngjarjes së raportuar dhe rregjistron ngjarjen në programin ECCAIRS.

4. IT, pas konsultimeve të mësipërme (me P.S dhe DD), dërgon Formën (AAC-MOR_07) tek drejtorja përkatëse për menaxhimin apo investigimin e tij. Pasi ngjarja dërgohet në drejtorinë përkatëse, secila drejtori do të kryejë trajtimin e ngjarjes internally sipas Manualeve të Brendshme të Operimit, të cilat duhet të harmonizohen me kërkesat e kësaj procedure, në zbatim të Urdhërave të Ministrit të sipërpërmendur.

¹ Kjo formë gjenden bashkelidhur kësaj procedure në Aneksin A

Drejtoria e Mbikqyrjes së Sigurisë në Aviacion së bashku me Drejtorinë e Mbikqyrjes së Aeroporteve dhe Aerodromeve do të përfshijnë në manualët e tyre të brendshme se si do t'i trajtojnë ngjarjet e ndodhura në lidhje me çështjen e Sigurisë, sulmet/goditjet nga zogjtë (Birdstrike), Mallrat e Rrezikshëm (Dangerous Goods) si dhe ngjarjet që kanë të bëjnë me shërbimet aeroportuale.

5. Drejtoria përkatëse vendos nëse ngjarja e raportuar duhet të investigohet apo jo. Nëse për ngjarjen që është raportuar nuk ka nevojë për investigim, drejtoria përkatëse rekomandon mbylljen e kësaj ngjarjeje dhe dërgon formën AAC-MOR_07 në Sektorin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë.

***Shënim:** Për një numër të konsiderueshëm të ngjarjeve të cilat raportohen në Autoritetin e Aviacionit Civil (të cilat plotësojnë kriteret për tu raportuar dhe që janë trajtuar nga organizata raportuese), nuk kërkohet investigim i mëtejshëm nga Autoriteti i Aviacionit Civil, pavarësisht se informacioni i raportuar duhet regjistruar në databazë.*

Që një ngjarje të klasifikohet e mbyllur nga Autoriteti i Aviacionit Civil duhet që informacioni që përmban raportin, në veçanti informacioni mbi veprimet e ndërmarra nga organizata raportuese të vërtetohet kontrollin e situatës.

6. Nëse ngjarja ka nevojë për investigim, Drejtori i Drejtorisë përkatëse ngarkon personelin përgjegjës për të investiguar ngjarjen.

7. Investigimi i ngjarjes, kryhet nga inspektori i ngarkuar duke përdorur të gjitha mjetet e mundshme, si kërkesa të investigimit apo sqarime nga operatorët, dokumenta, procedurat e operatorit, procedurat standarte të operimit, manualët e operimit dhe të mirëmbajtjes, të dhënat e sigurisë ose raportet e menaxhimit të sigurisë, vizita në terren tek operatorët dhe diskutimi mbi ngjarjen.

8. Inspektori investigues pas vlerësimit dhe investigimit të ngjarjes së ndodhur, duhet të paraqesë konkluzionet dhe rekomandimet në Formën (AAC-MOR_07).

9. Bazuar nga rekomandimet e inspektorit investigues, drejtoria përkatëse duhet të marrë vendimin për mbylljen apo jo të ngjarjes. Rekomandimet, të cilat janë paraqitur në Formën (AAC-MOR_07) duhet të dorëzohen në sektori e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë.

Afatet maksimale për dorëzimin e informacionit dhe dokumentave në lidhje me ngjarjen e raportuar do të jenë: Maksimumi 1(një) muaj për paraqitjen e masave korrigjuese dhe 3(tre) muaj për mbylljen e raportimit të ngjarjes.


10. Pasi Forma (AAC-MOR_07) është dorëzuar në sektori e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë, Inspektori përgjegjës në këtë sektor do të regjistrojë të dhënat në listën përmbledhëse të raportimit të ngjarjeve, gjithashtu do të kryej edhe updatimin e Formës (AAC-MOR_07) në programin ECCAIRS.

Çdo kordinator i emëruar në bazë të Urdhërit të Brendshëm të Drejtorit Ekzekutiv të Autoritetit të Aviacionit Civil, **Nr. 410 datë: 27.06.2014** ka të drejtë që nëpërmjet aplikacionit WebDAS të lexojë ngjarjet që janë regjistruar në programin ECCAIRS.

4.2 Procesi menaxhimit të Riskut për ngjarjet e raportuara në AAC

Harta përmbledhëse që ilustron procesin e menaxhimit të riskut është si më poshtë:

Figura.2: Procesi i Menaxhimit të Riskut



Procesi i menaxhimit të riskut fillon me identifikimin e riskut, i cili ka si qëllim të identifikojë riskun që ekziston dhe që mund të shkaktojë probleme të menjëhershme ose paraqet një rrezik në të ardhmen. Risku mund të konsiderohet si një objekt ose kusht që ka potencial për të shkaktuar lëndime të personave, humbje ose dëmtim të paisjeve, pronës, etj. Hapat e mëtejshëm, janë të lidhur me vlerësimin e riskut, përkatësisht në termat e shkallës së rëndësisë, probabilitetit dhe pranimit të riskut. Hapi i fundin është reduktimi i riskut. Përlllogaritjet për vlerësimin e riskut do të bëhen sipas formulës klasike të përlllogaritjes së riskut (ICAO)² të paraqitur si mëposhtë:

$$R = P \times S$$

Pra vlerësimi i riskut i shprehur në termat e probabilitetit dhe shkallën e rëndësisë së ngjarjes;

Procesi i vlerësimit të riskut fillon me vlerësimin e probabilitetit. Probabiliteti është përcaktuar si mundësia që të ndodh një situatë e rrezikshme. Për të bërë vlerësimin e probabilitetit mund të përdoren një sërë pyetjesh, si më poshtë:

² ICAO Doc 9859 (2013): "Safety Management Manual", Version 3, p.28, p.29, p.31

1. A ka ndonjë histori të ngjarjeve të ngjashme me atë që është duke u vlerësuar ose a është kjo ngjarje e izoluar?
2. Çfarë paisje të tjera apo lloje të ngjashme të komponentëve mund të kenë defekte të ngjashme?
3. Cili është numëri i personelit që duhet të ndjekë procedurën apo procedurat në fjalë?
4. Sa shpesh është përdorur paisja apo procedura që po vlerësohet?
5. Deri në çfarë shkalle janë implikimet organizative, menaxhuese apo rregullatore që mund të gjenerojnë kërcënime më të mëdha për sigurinë publike?

Në tabelën 1 është paraqitur një model i vlerësimit të probabilitetit, në këtë rast një tabelë me pesë pika. Tabela përfshinë pesë kategori për të treguar mundësinë lidhur me një situatë të rrezikshme, përshkrimin dhe vlerën për secilën kategori.

Tabela.1: Probabiliteti i ngjarjes

Përkufizimi	Kuptimi	Vlera
I vazhdueshëm	Ka gjasa të ndodh shumë herë (<i>ka ndodhur shpesh</i>)	5
I rastësishëm	Ka gjasa të ndodhi disa here (<i>ka ndodhur jo shpesh</i>)	4
I rrallë	Nuk ka gjasa, por ka mundësi të ndodhë (<i>ka ndodhur rrallë</i>)	3
I pamundur	Shumë e pamundur të ndodhë (<i>nuk dihet të ketë ndodhur ndonjëherë</i>)	2
Totalisht i pamundur	Pothuajse e pakonceptueshme që ngjarja të ndodhë	1

Pasi ka përfunduar vlerësimi i probabilitetit, hapi tjetër është vlerësimi i shkallës së rëndësisë të ngjarjes në terma të riskut (*severity*), duke marrë në konsideratë pasojat e mundshme që lidhen me riskun. Shkalla e rëndësisë së ngjarjes në termat e riskut (*severity*) është përcaktuar si efekti i mundshëm i një situatë të rrezikshme, duke marrë parasysh situatën më të keqe të parashikueshme.

Për të bërë vlerësimin e shkallës së rëndësisë në termat e riskut mund të bazohemi në pyetjet e mëposhtme:

1. Ngjarje fatale/ Lëndime. Sa jetë njerëzish mund të kenë humbur (punonjës, pasagjerë, kalimtarë)?

2. Dëmtim. Cila është shtrirja e mundshme e avionit, pronës apo paisjeve të dëmtuara?

Në tabelën 2 është praqitur një model i vlerësimit të shkallës së rëndësisë së ngjarjes, në të cilën përfshihen:

- pesë kategoritë, për të treguar nivelin e shkallës së rëndësisë;
- përshkrimi i secilës kategori;
- dhe vlera për secilën kategori.

Tabela.2: Shkalla e rëndësisë së ngjarjes

Përkufizimi	Kuptimi	Vlera
Katastrofik	Paisje të dëmtuara. Vdekje të shumta.	A
I rrezikshëm	Një reduktim i madh në nivelet e safety, lëndime fizik ose një ngarkesë pune të tillë që operatorët nuk mund të kenë kapacitetin për të kryer detyrat e tyre në mënyre të saktë dhe të plotë; Lëndime të rënda; Dëmtime të mëdha në paisje.	B
Madhore	Një reduktim të ndjeshëm në nivelet e safety, një reduktim në aftësinë për tu përballuar me kushtet e operimit si rezultat i rritjes së ngarkesës së punës, ose si rezultat i kushteve që pengojnë në efikasitetin e punës së tyre; Incident i rëndë; Lëndim fizik i personave.	C
I vogël	Probleme shqetesuese; Kufizime në operime; Përdorim i procedurave të emergjencave; Incident i vogel.	D
I parëndësishëm	Pasoja të lehta.	E

Të dyja vlerat së bashku, pra vlera e probabilitetit dhe shkallës së rëndësisë të ngjarjes përcaktojnë vlerën e riskut të një ngjarjes. Kombinimet përkatëse të probabilitetit dhe shkallës së rëndësisë të ngjarjes janë paraqitur në matricën e vlerësimit të riskut, në tabelën 3.


Tabela.3: Matrica e Vlerësimit të Riskut

Prababiliteti	Shkalla e rëndësisë				
	Katastrofik A	I rrezikshëm B	Madhor C	I vogël D	I parëndësishëm E
I vazhdueshëm 5	5A	5B	5C	5D	5E
I rastësishëm 4	4A	4B	4C	4D	4E
I rallë 3	3A	3B	3C	3D	3E
I pamundur 2	2A	2B	2C	2D	2E
Totalisht i pamundur 1	1A	1B	1C	1D	1E

Pasi është bërë edhe vlerësimi i riskut, hapi i tretë i këtij procesi është përcaktimi i tolerancës së riskut. Rezultati që merret nga matrica e vlerësimit të riskut (Tabela. 3) duhet të eksportohet në matricën e tolerancës së riskut (Tabela. 4). Për shembull, konsideroni një situatë ku probabiliteti i një ngjarjeje është vlerësuar si *i rastësishëm (4)* dhe shkalla e rëndësisë së ngjarjes është vlerësuar si *i rrezikshëm (B)*, kombinimi i këtyre dy vlerave (**4B**) përcakton riskun e ngjarjes së ndodhur. Duke u bazuar në tabelën 4, risku i ngjarjes së ndodhur që është vlerësuar si **4B** bie në **zonën e patolerueshme**. Në këtë rast, indeksi i riskut të ngjarjes së ndodhur është i pa pranueshëm. Prandaj Autoriteti i Aviacionit Civil duhet:

1. Të marrë masa për të zvogëluar ekspozimin e organizatës ndaj riskut të veçantë, pra të zvogëlojë komponentin e probabilitetit;
2. Të marrë masa për të zvogëluar shakllën e rëndësisë së ngjarjes dhe pasojave që lidhen me riskun, pra të zvogëlojë komponentin e shkallës së rëndësisë; ose
3. Të anullojë/pezullojë operimin nëse zbutja (mitigation) nuk është e mundur.

Tabela.4: Toleranca e riskut

Menaxhimi i riskut	Indeksi i riskut të vlerësuar	Kriteri i sugjeruar
	5A, 5B, 5C, 4A, 4B, 3A	I papranushëm sipas rrethanave ekzistuese.
	5D, 5E, 4C, 4D, 4E, 3B, 3C, 3D, 2A, 2B, 2C, 1A	I pranushëm bazuar në reduktimin (zbutjen) e riskut. Kjo mund të kërkojë vendim të mënaxhmentit.
	3E, 2D, 2E, 1B, 1C, 1D, 1E	I pranushëm.

Piramida e përmbysur, pasqyron një përpjekje të vazhdueshme për ta zhvendosur indeksin e riskut drejt kulmit të poshtëm të piramidës. Nga tabela 4 toleranca e riskut, risku është klasifikuar si i pranueshëm, tolerueshëm dhe i patolerueshëm.

Nëse risku i vlerësuar përfshihet në zonën e patolerueshme, ai nuk mund të pranohet. Pra nëse probabilitetit ose/dhe shkalla e rëndësisë së një ngjarjeje janë të një madhësie të tillë dhe përbëjnë një kërcënim për sigurinë, atëherë është e nevojshme zbutja e menjëhershme e veprimit. Ndërsa kur risku i vlerësuar bën pjesë në zonën e tolerueshme, ai është i pranueshëm, me kusht që strategjitë e duhura zbutëse janë zbatuar nga organizata. Një risk i cili fillimisht është vlerësuar si i patolerueshëm mund të zbutet (reduktohet) dhe më pas të zhvendoset në zonën e tolerueshme, me kusht që risqe të tilla të mbeten të kontrolluara nga strategjitë e duhura zbutëse. Nëse risku i vlerësuar bën pjesë në zonën e pranueshme, është i pranushëm dhe nuk kërkon zbutje (reduktim) të mëtejshëm të riskut. Ndërsa në tabelën 5 është paraqitur një shëmbull i një matrice alternative të tolerancës së riskut.

Tabela 5: Matricë alternative e tolerancës së riskut

Indeksi i riskut	Përshkrimi	Veprim i rekomanduar
5A, 5B, 5C, 4A, 4B, 3A	Risk i lartë	Në rast se është e nevojshme të ndalohet menjëherë operimi. Bëhet zbutja e riskut sipas prioriteteve për të siguruar se janë vendosur kontrolle shtesë parandalimi për të ulur indeksin e riskut në kufijtë e moderuar apo edhe më poshtë.
5D, 5E, 4C, 4D, 4E, 3B, 3C, 3D, 2A, 2B, 2C, 1A	Risk i moderuar	Nxirren statistika, përcaktohet grafiku i vlerësimit të riskut, për të ulur indeksin e riskut në një kufi më të ulët në rast se është e zbatueshme.
3E, 2D, 2E, 1B, 1C, 1D, 1E	Risk i ulët	Pranohet ashtu siç është. Nuk kërkohet zbutje e mëtejshme e riskut.

4.3 Grupi Vlerësimit të riskut

Drejtori Ekzekutiv krijon Grupin e Vlerësimit të Riskut. Grupi për vlerësimin e riskut përbëhet nga Drejtorët e Drejtorive teknike të cilët përfshihen në Raportimin e detyrueshëm të ngjarjeve si më poshtë:

- Drejtorja e Kontrollit të Cilësisë dhe Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë;
- Drejtorja e Mbikqyrjes së Operatoreve Ajror dhe Organizatave të Miratuara të Mirëmbajtjes;
- Drejtorja e Mbikqyrjes së Shërbimeve të Lundrimit Ajror;
- Drejtorja e Mbikqyrjes së Aeroporteve dhe Aerodromeve;
- Drejtorja e Mikqyrjes të Sigurisë në Aviacion.

Çdo tre muaj do të kryhet mbledhja me pjestarët e këtyre drejtorive në lidhje me vlerësimin e riskut.

Mbledhje ad-hoc mund të kryhen në raste kur mund të lind nevoja për çështje specifike ose për raste kur duhet të shqyrtohen ngjarje me rëndësi të veçante apo që duan një identifikim risku imediat.

Objektivi i këtyre mbledhjeve është të kalojë për rishikim të gjitha ngjarjet e ndodhura për periudhën, të cilat do t'u vihen në dispozicion nga Sektori përgjegjës për MOR dhe raportimin e ngjarjeve në ECCAIRS pranë DKCSMS. Këto mbledhje kanë si qëllim për të garantuar që të gjitha ngjarjet janë raportuar, investiguar, veprime korigjuese janë ndërmarrë siç duhet dhe janë analizuar për tendencat e tyre.

Në bazë të shqyrtimit të këtyre ngjarjeve, Grupi i Vlerësimit të Riskut vendos nëse në bazë të ngjarjeve të shqyrtuara kemi një risk të ulët, normal apo të lartë, dhe gjithashtu të vendosë se cilat nga ngjarjet kërkon investigim nga AAC-ja. Për ngjarjet që klasifikohen si incidente të rëndësishme apo aksidente do të shkembet informacioni i duhur me OKIIAn.

Grupi i vlerësimit të riskut duhet të analizoj ngjarjet dhe informacionin e raportuar për të zbuluar nëse mund të ketë probleme të safety të cilat mund të mos jenë të dukshme për vetë raportuesit. Ky grup mund të vërë të dhënat e analizave (statistikat) në lidhje me raportimet e ngjarjeve, në dispozicion të palëve të interesuara, në mënyrë që të përdoren për përmirësimin e sigurisë në operim.

Në rast të ngjarjeve të përsëritura apo në identifikimin e mundësive për përsëritje të një ngjarje si dhe për rastet e ngjarjeve që mund të kenë impakt të rëndësishëm në safety, ky grup i vlerësimit të riskut në bashkëpunim me drejtorinë teknike e cila mbulon mbikqyrjen e atij aktiviteti, lëshon këshilla dhe rekomandime (safety recommendation).

Autoriteti i Aviacionit Civil, në fund të vitit harton një raport për ngjarjet e raportuara, i cili përmban informacion mbi llojet e ngjarjeve të mbledhura nga ana e sistemit të tij të detyrueshëm të raportimi të ngjarjeve, për të informuar publikun mbi nivelin e sigurisë në aviacionin civil.

5. Aneksi A: Forma për ndjekjen dhe mbylljen e ngjarjes së raportuar

Numëri	Data e Ngjarjes	Operatori/Vendndodhja	Tipi i Avionit & Callsign / Regjistrimi	Tipi i Ngjarjes
Organizata Raportuese & Data e Raportimit:				
Përshkrim i Ngjarjes:				
Inspektor/Përgjegjësi i SMS:		Firma:	Data:	
Inspektori/Përgjegjësi i SMS e dërgon Formën AAC_MOR-07 tek Drejtoria Përkatëse				
Marrja në dorëzim nga Drejtoria/Spektori përkatës:				
Firma:				
Data:				
Shënime mbi rezultatet e rishikimit/Investigimit të ngjarjes:				
Rekomandimet e Inspektorit Investigues:				
Vlerësimi i riskut dhe Vendimi i Inspektorit Investigues:				
Statusi i Ngjarjes: Mbyllur <input type="checkbox"/> Hapur <input type="checkbox"/>		Firma:	Data:	
Inspektori/Përgjegjësi i SMS:		Firma:	Data:	
Kur ngjarja është mbyllur Inspektori/Përgjegjësi i SMS përditëson të dhënat në programin ECCAIRS.				